



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:022691
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05524624
C.nr.927/2023

GJYKATA THEMLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.S., të cilën e përfaqëson Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson E.Ç., për kompensim për ushqim gjatë punës, duke vendosur sipas marrëveshjes se palëve të arritur nga ndërmjetësuesi, N.O., ndërmjetësues i licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes se palëve të arritur në ndërmjetësim, me dt.29.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET Marrëveshja ND: 624/2024 e dt.15.03.2024 e arritur në procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.927/2023.
2. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi